



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



V E N D I M

Nr. 5 Datë: 08.04.2021

“MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2022-2024 DHE RAPORTIN PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 08.04.2021, pasi dëgjoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër **“Mbi miratimin e Tavanëve Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe Raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të Ardhurave”**, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015”Për Vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenin 34 të ligjit nr. 68/2017”Për Financat e vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimit Nr.7, datë 26.02.2021 ”Për përgatitjen e Programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”. Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj. Bazuar në Aktin Normativ Nr.03 datë: 15.03.2020 konkretisht neni 5, ” *për vendimarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19*”, si dhe bazuar në Urdhërin Nr.80 datë 17.11.2020 *“për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19...bazuar në Urdhërin nr.633 datë 17.11.2020 “për ndalimin e grumbullimeve me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura...”*,

Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, , pas relativitetit nga zyra e drejtorisë së financës dhe buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **13 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim.**

Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

V E N D O S I ;

1. Të miratojë Tavanet Përgatitore të shpenzimeve të **Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024** , për Këshillin e Qarkut Shkodër sipas pasqyrave bashkangjitur.
2. Të miratojë **Raportin për Vlerësimet dhe Parashikimet Afatmesme të të Ardhurave të Këshillit të Qarkut Shkodër për;**



- a) Dy vitet para vitit buxhetor,
 - b) Vitin buxhetor,
 - c) Tre vitet e ardhshme buxhetore,
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
 4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI
Hilmi LAKTI

Tavanet e PBA - 2022-2024

Planifikimi i Shpenzimeve të Programit			2022-2024		TAVANET		
2022-2024		Tavanet e PBA për institucionin dhe Tavanet e Programit					
Emri i Entit:		KESHILLI I QARKUT SHKODER					
Numri i Grupit:							
		Mijë Lekë					
Tavani i Institucionit				Buxheti		PBA 2022-2024	
		Emri i Artikullit	Nr. i Artikullit	2021	2022	2023	2024
TOTALI		Paga	600-601	22,813.0	22,813.0	23,313.0	23,313.0
		Korente të tjera	602-606	22,087.0	13,519.0	13,610.0	13,709.0
		Kapitale	230-231	62,211.0	28,221.0	32,677.0	35,664.0
		Jashtë-buxhetore		16,007.0	11,242.0	26,599.0	0.0
		Totali		123,118.0	75,795.0	96,199.0	72,686.0
Alokimi i Tavanit për Programet							
				Buxheti		PBA 2022-2024	
Emertimi i Programit		Emri i Artikullit	Nr. i Artikullit	2021	2022	2023	2024
Administrata KQ Shkoder		Paga	600-601	17,500.0	17,500.0	18,000.0	18,000.0
		Korente të tjera	602-606	17,874.0	12,740.0	12,831.0	12,930.0
Nr. Titullit Programor		Kapitale	230-231	4,382.0	9,500.0	1,500.0	500.0
01110		Jashtë-buxhetore					
		Totali		39,756.0	39,740.0	32,331.0	31,430.0
Alokimi i Tavanit për Programet							
				Buxheti		PBA 2022-2024	
Emertimi i Programit		Emri i Artikullit	Nr. i Artikullit	2021	2022	2023	2024
Turizmi		Paga	600-601				
		Korente të tjera	602-606	3,934.0	500.0	500.0	500.0
Nr. Titullit Programor		Kapitale	230-231				
04760		Jashtë-buxhetore		1,741.0			
		Totali		5,675.0	500.0	500.0	500.0
Alokimi i Tavanit për Programet							
				Buxheti		PBA 2022-2024	
Emertimi i Programit		Emri i Artikullit	Nr. i Artikullit	2021	2022	2023	2024
Investime rrugore		Paga	600-601				
		Korente të tjera	602-606				
Nr. Titullit Programor		Kapitale	230-231	6,468.0	18,721.0	31,177.0	35,164.0
04520		Jashtë-buxhetore					
		Totali		6,468.0	18,721.0	31,177.0	35,164.0
Alokimi i Tavanit për Programet							
				Buxheti		PBA 2022-2024	
Emertimi i Programit		Emri i Artikullit	Nr. i Artikullit	2021	2022	2023	2024
Ujesjellesi		Paga	600-601				
		Korente të tjera	602-606				
Nr. Titullit Programor		Kapitale	230-231	51,361.0			0.0
06330		Jashtë-buxhetore		11,242.0	11,242.0	26,599.0	
		Totali		62,603.0	11,242.0	26,599.0	0.0
Alokimi i Tavanit për Programet							
				Buxheti		PBA 2022-2024	
Emertimi i Programit		Emri i Artikullit	Nr. i Artikullit	2021	2022	2023	2024
DAMT		Paga	600-601	5,313.0	5,313.0	5,313.0	5,313.0
		Korente të tjera	602-606	279.0	279.0	279.0	279.0
Nr. Titullit Programor		Kapitale	230-231				
01160		Jashtë-buxhetore					
		Totali		5,592.0	5,592.0	5,592.0	5,592.0
Alokimi i Tavanit për Programet							
				Buxheti		PBA 2022-2024	
Emertimi i Programit		Emri i Artikullit	Nr. i Artikullit	2021	2022	2023	2024
Ministria e Shëndetsise		Paga	600-601			0.0	0.0
		Korente të tjera	602-606			0.0	0.0
Nr. Titullit Programor		Kapitale	230-231				
10460		Jashtë-buxhetore		3,024.0			
		Totali		3,024.0	0.0	0.0	0.0
Miratimi		Nepunesi Zbatues		Nepunesi Autorizues			
		Emri:		Emri:			
		Nënshkrimi:		Nënshkrimi:			
		Data:		Data:			

KESHILLI QARKUT SHKODER
PERMBLEDHESE E TE ARDHURAVE

000/leke

Nr	Emertimi i të Ardhurave Tatimore	Fakti 2019	Fakti per vitin 2020	Buxheti per vitin 2021	Buxheti per vitin 2022	Buxheti per vitin 2023	Buxheti per vitin 2024
A	Të ardhura						
I	Të ardhura nga tarifat	84	906	300	300	300	300
a	Tarifë për konfirmim hartash	14	41	100	100	100	100
b	Tarifë për shërbime administrative(dok. Arshivore)	16	29	100	100	100	100
c	Tarifë shërbim Kadastral	55	47	100	100	100	100
d	Teardhura te tjera		790	0	0	0	0
II	Të ardhura te ndryshme	200	143	2,940	2,000	2,000	2,000
a	Te ardhurat nga kuota vjetore e bashkive	200	143	2,940	2,000	2,000	2,000
A	Totali i te ardhurave te veta (I+II)	284	1,049	3,240	2,300	2,300	2,300
B	Transferta e pakushtezuar	43,801	37,449	56,661	56,661	61,708	64,794
E	Te trasheguara	28,751	320	41,618	0	0	0
C	Transferta e kushtezuar DAMT	5,531	5,207	5,592	5,592	5,592	5,592
C1	Transferta e kushtezuar Shtepia FACIBENI	0	1,993	3,024			
C2	Transferta e kushtezuar AGJENC KONB UJESJ.KAN		0	11,242	11,242	26,599	
D	Financime te huaja	0	235	1,741	0	0	0
	ADRIATICAVES (Thesari)	0	0	1,741	0	0	0
	ADRIATICAVES (Banka nivelit dyte)		235	0	0	0	0
	Totali I te ardhurave (2022-2024)	78,083	45,204	123,118	75,795	96,199	72,686

Nëpunësi Zbatues
Gjyqjana MIRUKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Nr. Prot: 153



Shkodër me 17.03.2021

RELACION

“Mbi miratimin e taveve Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe Raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të Ardhurave”

Në zbatim të në nenit 34 të ligjit 68/2017 “ Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimit Nr.7, datë 26.02.2021 ”Për përgatitjen e Programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”, bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, kemi përgatitur dhe po paraqesim për miratim analizën dhe vlerësimin e të ardhurave dhe tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 .

I-Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të Ardhurave për:

1. Vitin buxhetor 2021,
2. Dy vitet para vitit buxhetor dhe konkretisht fakti i vitit 2019 dhe 2020, pasqyruar në tabelën F1 në buxhetin e vitit 2021 dhe ne tabelen bashkangjitur.
3. Për tre vitet e ardhëshme buxhetore dhe konkretisht për vitet 2022 dhe 2023 dhe për vitin 2024 janë përcaktuar tavanet duke u nisur nga vlera absolute e miratuar në udhëzimin e lartpërmendur për shumën e transfertës së pakushtëzura për vitet respektive buxhetore dhe të ardhurat e vendosura duke ruajtur raportin e viteve 2022-2024.

a) Metodologjia e përdorur për parashikimet e të ardhurave

Duke u nisur nga kuadri ligjor të ardhurat që Këshillat e Qarqeve mund të arkëtojnë, janë tarifata për shërbimet që kryhen për konfirmime hartash, nxjerrje dokumentash arshivore dhe tarifa për shërbime të kryera nga funksioni i deleguar DAMT.

Parashikimet e këtyre të ardhurave janë bërë bazuar në të ardhurat faktike të vitit të fundit kalendarik, të cilat bazuar në situatën e krijuar nga pandemia janë ulur në mënyrë të ndjeshme dhe në krijimin e mundësive për rritjen e tyre, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

Kuadri Makroekonomik e fiskal për periudhën 2022-2024, për Këshillat e Qarqeve, si njësi e nivelit të dytë të qeverisjes vendore, është shumë i kufizuar.

Kuotat e antarësisë së bashkive përbërëse të Qarkut Shkodër, megjithëse zenë pjesën më të madhe të të ardhurave totale të KQSh, megjithëse vendoset nga bashkitë me vendim të Këshillit Bashkiak,

kjo kuotë është vendosur duke parë tendencën e viteve të fundit dhe të ardhurat faktike nga kuota e anëtarësisë, pasi megjithëse kjo kuote planifikohet ne buxhetet e bashkive, nuk mblidhen të ardhura nga bashkitë dhe si pasojë nuk bëhen veprimet ekonomike për transferimin e saj në buxhetin e KQSH.

Sic shihet ne tabelen që përmban të dhënat për parashikimet afatmesme të të ardhurave, në vitin 2019, fakti i të ardhurave nga kuota e anëtarësisë ka qenë 200 mijë lekë ndersa në vitin 2020 fakti i të ardhurave nga kuota e anëtarësisë ka qenë 143 mijë lekë.

Planifikimi i kuotës së antarësisë nga bashkitë e qarkut Shkodër , për vitin 2019 eshte në masën 2,840 mijë lëke dhe është realizuar 7% dhe për vitin 2020 është planifikuar në masën 2,140 mijë lekë dhe është realizuar 6.68%.

Planifikimi i kuotës së antarësisë nga bashkitë e qarkut Shkodër, për vitet 2022-2024, është bërë bazuar në planifikimin që është bërë ne PBA 2021-2023.

b) Analiza e efekteve të politikave fiskale .

Këshilli i Qarkut shkodër, bazuar në llojin e të ardhurave që mund të arkëtojnë siç janë tarifat për shërbimet që kryhen për konfirmime hartash, nxjerrje dokumentash arshivore dhe tarifa për shërbime të kryera nga funksioni i deleguar DAMT, politikat e reja fiskale, nuk kanë dhënë efekt tek tarifat e planifikuara te të ardhurave, pasi këto të ardhura lidhen me lëshime dokumente ardhivore , te cilat si rezultat i ndryshimeve ligjore, janë pak të kerkuara.

Në tabelën PERMBLEDHESE E TE ARDHURAVE, paraqiten te ardhurat e planifikuara sipas llojit te tyre për vitin buxhetor, faktin e të ardhurave për dy vitet e mëparshme buxhetore si dhe per 3 vitet e ardhshme buxhetore, 2022-2024. Planifikimi i ketyre tw ardhtrave nga tarifat eshte bwr edhe per tre vitet e ardhshme duke u bazuar ne planin e vitit 2021.

c) Analiza e rrisqeve dhe masat për përballimin e tyre.

Nisur nga kuadri ligjor i të ardhurave , KQShkodër bën planifikimin e tyre në mënyrë të tillë që të mos ketë efekt negativ në përmbushjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të cilat janë të sanksionuara në ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”

Pesha specifike e të ardhurave të planifikuara dhe të realizuara në raport me të ardhurat totale nga burimet e tjera për Kqshkodër është shunmë e vogël.

Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të miratuara si dhe në transfertat e pakushtëzuara të përcaktuara në vlerë absolute në Udhëzimin nr.7, date 26.02.2021 te Ministrisë së Financave, i protokolluar pranë KQShkodër me nr 143, datë 11.03.2021, janë përgatitur dhe i paraqesim për miratim tavanet përgatitore të shpenzimeve për PBA-në 2022-2024 në nivel programi të cilat do të shërbejnë për përgatitjen e PBA-së 2022-2024 në vazhdim sipas afateve të përcaktuara ligjore.

II-Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024

Tavanet përgatitore janë pasqyruar sipas programve dhe paraqitur ne pasqyren Planifikimi i Shpenzimeve të Programit 2022-2024.

Siç shihet nga tabela, tavanet përgatitore janë të ndarë sipas programeve si më poshtë;

1. ***1-Programi Organet Ekzekutive dhe Legjislative (Planifikim, menaxhim, administrim).***
Progr.1a- Programi 01110
Progr.1e- Programi 01160, DAMT, funksion i deleguar
2. ***Nënfunkcioni 8-Rrjeti Rrugor***
Progr. 8a- Programi 04520
3. ***Nënfunkcioni 9-Zhvillimi i Turizmit***
Progr. 9b- Programi 04760
4. ***Nënfunkcioni 16- Furnizimi me uje***
Progr.16 a Programi 06330

1-Programi Organet Ekzekutive dhe Legjislative (Planifikim, menaxhim, administrim).
Progr.1a- Programi 01110

Progr.1a- Programi 01110, përfshin planifikimin, menaxhimin e administrim për administratën e institucionit tone, për të mundësuar përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave sipas kuadrit ligjor në fuqi siç janë shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore, shpenzime korrente ku përfshihet aktivitetet për kryerjen e funksioneve të qarkut, transfera të brendshme dhe të jashtme si dhe shpenzime për investime për vitet 2022-2024.

Programin 1e (01160), planifikimin, menaxhimin e administrim për DAMT, funksion i deleguar pranë institucionit tone i cili operon me transferte të kushtëzuara të ardhur nga pushteti qendror. Kjo transfera ndryshon nga viti në vit dhe për këtë arsye për të përcaktuar transferen për PBA-në 2022-2024, marrim në konsideratë transferen e vitit 2021.

2. ***Nënfunkcioni 8-Rrjeti Rrugor***
Progr. 8a- Programi 04520

Shuma e përcaktuar në PBA-në, përfshin tavanet për investime rrugore për 3 vitet 2022 deri 2024. Pritet vendimi nga bashkë të qarkut Shkoder, se si do të përdoren shumat e planifikuara sipas tavanit të përcaktuar.

3. ***Nënfunkcioni 9-Zhvillimi i Turizmit***
Progr. 9b- Programi 04760

Në këtë program përfshihet shuma e planifikuar për bashkefinancim me projekte të BE-së, meqë këto projekte e kanë kusht kryesor shumën për bashkefinancim, kjo e ndarë për 3 vitet sipas PBA-së.

4. ***Nënfunkcioni 16- Furnizimi me uje***
Progr.16 a Programi 06330

Në këtë program pasqyrohet shuma e fondeve buxhetore të kushtëzuara nga pushteti qendror për investimin e nisur nga KQShkoder për Ndërtimin e Ujësjetës Muriqan dhe të paraqitura në tabelën e taveve në rubrikën "Jashtë buxhetore"

NËPUNËSI ZBATUES

Gjyljana MIRUKU

